



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0020693-2/70 dt. 20.04.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0020693/26, dt. 16.04.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për hartimin e Draft - Rregullores për Varrezat, Ofrimin e shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre)

1. FORMOHET Komisioni për hartimin e Draft - Rregullores për Varrezat, Ofrimin e shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fatime Hyseni – kryetare (DSHPI);
 - 1.2 Fisnik Ibrahim – anëtar (DSHPI);
 - 1.3 Rexhep Hajdari – anëtar (DSHPI);
 - 1.4 Gjylferije Ademi-Kadri – anëtare (DSHPI);
 - 1.5 Naser Shala – anëtar (DBF).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë hartimin e Draft - Rregullores për Varrezat, Ofrimin e shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre, duke përfshirë të gjitha propozimet nga drejtoritë komunale që implikohen në zbatimin e saj, dhe të bëjë harmonizimin e tyre me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartojë draft-rregulloren në afat më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.



6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës


Faton PEÇI

Shtojcë:

Propozim-Vendimi i Nr. 01-020/04-0020693/26, dt. 16.04.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

